

BIBLIOTEKA

88H-1
E 45

Nexhip
Ejupi

PESHA E DUARVE



*vjersha
dhe
poema*

88H-1
E 45

Nexhip Ejupi

PESHA E DUARVE

*vjersha
dhe
poema*

43413

12413

MONOLOGU I AGRONOMIT

Jam diku në mes të fushës së pamatë,
Miku i përhershëm i hapësirave me blerim,
Kallinjtë në lartësinë e shpatullave të mia,
Seç thonë për mua ca fjalë pa pushim.

E di kuptimin e fëshfërítjes së grurit,
Që më ndjek sonte hap pas hapi në arë,
Ajo më skaliti bashkë me tiparet e burrit,
Krenarinë dhe shqetësimin e përditshëm në ballë.

Kjo fëshfërimë, e gjëzueshme vjen që poshtë fushës,
Që thellë tokës, ku flenë ëndërrat e stërgjyshërvë të
mi,
Është gjuha shumë e lashtë dhe shumë e re e bukës,
Që flet me fëshfërimën e këtij gruri të ri.

N I S J E T U M O R O W I A G R O N O M I

Kokat e vogëlushëve të kërrusura janë
Mbi fletoret me vija, mbi bukurshkrim,
Mësuesja përkulet nga banga në bangë,
Në sy e në ballë seç ka një shqetësim.

I shkruar me shkumës shqetësimi zbardh,
Po duhet hedhur në fletoret me vija,
Germat, dorëpërdore si vogëlushët në radhë,
Kapen me merakun e penës në gishta.

Fleta me vija po mbushet pak nga pak,
(Shqetësimi i mësueses kalon tek ata),
Alfabeti i diturisë zë fill nga ky merak,
Universiteti çel udhën që nga shkronja «A».

PJEKURIA DHE FËMIJËRIA

U rritëm, shok, u bëmë burra,
Tani në flokë na dalin thinja,
Në ballë mendimet gdhendin rrudha,
Me to nái gdhëndet pjekuria.

Po prapëseprapë me këmbëngulje,
Jo si mohim për pjekurinë,
Në shpirt diku na çelin lule,
Kujtimet për fëmijërinë.

Të mos kish sythe në fillim,
S'do kishte frute kurrë më vonë,
E lidhur rri me pjekurinë
Kjo moshë e sytheve të njomë.

GJASHTË DITË

Janë gjashtë ditë në jetën time, gjashtë,
Që më bënë me plot gojën njeri,
Jo se në ato ditë u bëraq së pari baba,
Porse rroka së pari fshesën në shtëpi.

Atë fshesë nuk ia shkova vetëm shtëpisë,
Ndjeva së ajo fshesë po më pastronte dhe mua,
Ato gjashtë ditë më bënë amvisë,
Në kohën që ti bëheshe nënë, grua...

N G R O H T E S I

Ngrohtësi nuk jep vetëm druri kur digjet,
Apo nafta, qymyri, që i gjejmë në thellësi,
Dëgjo shokun tënd që e pyet e të përgjigjet,
A nuk ndien të çlirohet prej fjalëve ngrohtësi?

T'I SHTYPIM NË VEZË

Pësh-pësh... Pësh-pësh...
E more vesh?
Pësh-pësh... Pësh-pësh...
S'e mora vesh...

— Mos i ke veshët
Zënë me pambukë?
— Po ti moj korbë,
A ke ngrënë bukë?

Pa qasu pranë,
Ta them në vesh,
Pësh-pësh... Pësh-pësh...
Kujdes... Kujdes...

— E di mirë ti? *është e mirë*
— E di mirë, pra. *është e mirë*.
Vërtet? Hi-hi! *është e mirë*.
Vërtet! Ha-ha! *është e mirë*.

Po ti, lexues; *çfarë po i di*
A more gjë vesh; *çfarë po i di*
Nga kjo gjarpërítje; *çfarë po i di*
Prej gojës në vesh? *çfarë po i di*

Mes gojës dhe veshit
Megafoni i dorës,
Në vrimë të veshit
Hyn helmi i gojës.

— Ish shef i mirë,
Por, ah, ç'e do...
Qyqja, ky tjetri!
Bubu!...Bobo!...

— E pe Selvinë?
S'e mendoja kurrë!
Shyqyr që gjeti
Një copë burrë!

Nga bota e vjetër
Në ditët tonë
Enden ca shpirtra,
Ca hije, kufoma...;

Pësh-pësh... Sytë katër
T'i bëjmë kudo,
T'i shtypim në vezë,
Përndryshe ato...

Shqipëri i ri i përfundit
Dëgjohet që është i rënë
Dëgjohet që është i rënë
Dëgjohet që është i rënë

Dëgjohet që është i rënë
Dëgjohet që është i rënë
Dëgjohet që është i rënë
Dëgjohet që është i rënë